



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-Autoriteti i Konkurrencës-

Njoftim për mediat

**Mbi memorandumimin e mirëkuptimit ndërmjet
Autoritetit të Konkurrencës (AK) dhe Entit Rregullator të Sektorit të
Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
(ERRU)**

Tiranë 23 shkurt 2011 – Autoriteti i Konkurrencës dhe Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) nënshkruan një memorandum mirëkuptimi me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndër-institucional për lehtësimin e kryerjes së funksioneve përkatëse të këtyre institucioneve. Ky memorandum u nënshkrua nga Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës Znj. Lindita Milo (Lati) dhe Kryetari i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura z. Avni Dervishi, në mjediset e ERRU.

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve është e nevojshme duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm të politikës së konkurrencës në promovimin e zhvillimit efektiv në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura. Kjo për arsye se sektori i furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura ka pësuar zhvillime të qenësishme vitet e fundit në kuadrin e reformimit thelbësor që synon një sektor financiarisht të vetë-qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Autoriteti dhe ERRU kanë përgjegjësinë e mbrojtjes së operatorëve dhe konsumatorëve nga veprimet abuzive në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Më konkretisht, palët angazhohen që të përcaktojnë fushat dhe mënyrat e bashkëpunimit për vendosjen dhe garantimin e zbatimit të rregullave për të nxitur konkurrencën aty ku është e mundur në operatorët e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Në këtë drejtim Autoriteti bashkëpunon për nxitjen e konkurrencës duke dhënë mendimet e tij për aktet ligjore dhe nënligjore që vendosin rregulla sjellje në këtë sektor. Të gjitha projektet e akteve nënligjore të nxjerra prej palëve, që lidhen me operatorët e këtij sektori dhe që referojnë vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për operatorë të caktuar, do të konsultohen paraprakisht me Autoritetin, me qëllim funksionimin normal të sektorit në përputhje me objektivat e detyrimeve ligjore.

ERRU gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligj, do të veprojë në mënyrë të tillë, që aty ku është e mundur dhe efikase, të nxisë konkurrencën. Të dy palët do të publikojnë dhe/ose shkëmbejnë zyrtarisht të dhëna dhe informacione, në masën që lejojnë dhe detyrojnë ligjet ku bazohet ky memorandum, duke respektuar në rast nevojë karakterin e tyre konfidencial.

Ligji nr. 9121 , datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) në pjesën e pestë të tij, vendos detyrimin e enteve të ndryshme shtetërore që të kërkojnë vlerësimi e Autoritetit të Konkurrencës për projekt-aktet që mund të sjellin një kufizim apo pengim të konkurrencës. Gjithashtu, ligji përcakton bashkëpunimin e Autoritetit të Konkurrencës me entet e ndryshme rregullatorë për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në sektorët e rregulluar. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës ka nënshkruar një sërë memorandumesh bashkëpunimi me Bankën e Shqipërisë, AKEP, ERRE etj.

Autoriteti i Konkurrencës është organ publik, i pavarur në kryerjen e detyrave të veta dhe përgjegjës për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kontrollon rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, nxjerr akte detyruese për zbatimin e tyre dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore për sigurimin e rregullave të vendosura për konkurrencën;

ERRU është institucion publik, i pavarur i cili vepron në baze të Ligjit Nr.8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujrave të ndotura” (i ndryshuar) dhe ka për objekt kryesor garantimin dhe mbrojtjen e interesave publike nga njëra anë, si dhe krijimin e një mjedisi transparent ligjor dhe rregullator, që do të nxisë investimet private në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e perpunimit të ujërave të ndotura.